



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2018:016703

Datë: 26.04.2021

Numri i dokumentit: 01730438

P.nr.19/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL Sipas gjyqtarit Nexhat Aliu, me Sekretare Juridike, Azize Rama, në qështjen penale të të akuzuarëve NN dhe NN që të dy nga fsh. NN, K.Vitise, te akuzuar për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 185 paragrafi 1, të KPRK-së, e sipas aktakuzes PP.II.nr.10/2018, të datës 15.01.2018 ,dhe pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, me datën 30.03.2021, shpall me dt.31.03.2021 këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari NN nga babai NN, dhe nëna NN, i vajzeris NN, i lindur 08.09.1981 në Viti, ndërsa jeton ne fsh.NN K.Vitise, me nr.personal 1006199409, ka te kryer shkollen e lartë politenik, me pune ne Shtetin e Gjermanise, me gjendje të mesme ekonomike, i martuar, babai i 3 fëmive, deri me tani kinse i pa dënuar, shqipar , shtetas i Republikës së Kosoves dhe Maqedonise.

ËSHTË FAJTORË SEPSE

Me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e pare të aktakuzës , i pandehuri NN, pas një mosmarrveshje me të pandehurin e pare tani i dëmtuari NN, rreth një prone dhe me qëllim të shkaktimit të friksimit dhe të ankthit, për derisa i njëjti sa kishte dalur nga séance gjyqsore , në korridoret të gjykatës ,I pandehurie kishte kanosur seriozisht me fjalët “hajde te ara dhe ka ngritur dorën në bel dhe ka me të vra dhe nuk guxon me shku te ara dhe nëse e fiton me gjykat”dhe në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e vrta tek i pandehuri i pare-tani i dëmtuar ka shkaktuar frikë,dhe pasiguri në jetë.

-me çka ka kryer vepër penale Kanosje , nga neni 185 paragrafi 1, të KPRK-së.

-andaj gjykata në bazë të nenit 38,39, 43 e 69 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPRK-së.

E G J Y K O N

Me denim gjobë në shumë prej **200.00 Eu, (dyqind euro).**

Denimin e shqiptuar do ta paguaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast të mosë pagesës i njejt do të shendrrohet në denim burgu efektiv prej **10 ditësh**, duke llogaritu nga **20.00 Euro (njizeteuro)**, për një ditë burgu.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale ti paguaj Gjykatës shumë prej **20.00 Euro (njizet euro)** dhe paushallin gjyqësor në shumë prej **10.00 euro (dhjetë euro)**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari Velibor Duceviq, për realizimin e kërkeses pasurore juridike udhëzohet në kontekst civil.

në bazë të nenit 160 të KPPRK,

PUSHOHET procedura penale ndaj të akzuarit NN nga fshati Podgorc, K. Viti, e filluar sipas aktakuzës të PSh-re, nga Gjilani PP.nr. 10/2018, të datës 15.01.2018, për veper penale, kanosje nga neni 185 parag.1 të KPRK-së, **për shkak të vdekjes së të akzuarit.**

A r s y e t i m

PSh-re, nga Gjilani me datën 15.01.2018, ka ngritur aktakuzën PP.II. nr. 10/2018, kundër të akzuarve NN dhe NN që të dy nga fshati NN, K. Viti, për shkak të veprës penale kanosje, nga neni 185 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që të njëjtit të shpallë fajtorë dhe ti dënonë me dënim meritator sipas ligjit.

I akuzuari NN e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë si në aktin akuzues dhe pse ka qenë i njoftuar me pasojat dhe favoret e pranimi të fajsisë.

PSh-re nga Gjilani, Rozelida Manastiri në fjalën përfundimtare të palve ka deklaruar : Me qense ne shqyrtimin e sotëm fillestare i akuzuari e pranoj fajsin për vepren penale e cila e ngarkon si në aktakuzë dhe fajsin e pranoj me vetedije te plote pase njoftimin nga ana e gjykata per benifitet dhe pasojat e pranimi te fajsis keshtu me pranimin e fajsis rezulton se eshte vertetuar siq eshte pershkruar ne dispozitiv te aktakuzes.

Andaj mbetem pranë aktakuzës dhe propozimet te cilat i permban e njejta dhe kërkoj nga gjykata që të akzuarin ta shpalle fajtor duke i shqiptuar saksionit te paraparë ligjor e qe para se të përcaktohet për llojin dhe lartesis e dënimit propozoj të gjitha rrethanat qofte ato lehtesuese dhe rendesuese ne menyre qe ti shqipton nje saksion penal adekuat i cili do te arrihet qëllimin e dënimit dhe njiherit te jete si priventiv për të pandehurin por edhe per personat te tjere ne rrethin ku jeton i pandehuri qe te permbahet nga krytja e vepres penale.

I akuzuari NN në fjalën përfundimtar të palve ka kërkuar nga gjykata që t'i shqipton nje dënim ma te butë, është pënduar për kryrjen e kësaj vepre penale i ka premtuar gjykatës që në të ardhme nuk do të kryej vepëra tjetra penale të këtij lloji apo te llojit tjeter.

Gjykata analizoi mbrojtjen e të akuzuarit, provat e bashkangjitura në aktin akuzues dhe erdhi në përfundim se i akuzuari NN nga fsh.NN K.Vitise, ka kryer veprën penale, kanosje nga neni nga neni 185 parag.1 të KPRK-së, që u vërtetua nga pranimi i fajsisë nga ana e vetë të akuzuarit për këtë veprë penale.

Gjatë matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata ka marrë parsysh, pranimin e fajsisë pa asnjë hezitim qyshë në seancën fillestare, pendimin, premtimin se nuk do të përsëris kryerjen e veprës penale, është njeri familjar babai i 3 femijeve , më pare nuk ka qenë i dënuar dhe se për gjykatën nuk është i njohur si kryes i veprave penale të këtij lloji apo të ndonji lloji tjetër.

Ndersa rrethana rënduese pati parsysh pergjegjsin penale, rrezikshmerin shoqrore, menyrjen e kryerjës së vepres penale nga se i akuzuari ka diturë se veprimet e ndermarrura janë në kundërshtim me ligjin, dhe pasojat që i jan shkaktuar të dëmtuarit me këtë veprë penale.

Gjykata sa i perket të akuzuarit NNka marrur konfirmimin nga ana e policies me dt.18.02.2021, se ku I akuzuar nuk është në jtë qe dy vite, nga keto arsye gjykata ka vendosur si në dispozitiv.

Për këtë arsye i shqiptoi denim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë i bindur se edhe ky denim do të ndikoi pozitivishtë tek i akuzuari.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 450, ndersa vendimi mbi kërkesën pasurore juridike konfomr nenit 458 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELOR GJILAN DEGA NË VITI
P.nr.19/2018
Me. 31.03.2021

Sekretare Juridike,
Azize Rama

Gj y q t a r i,
Nexhat Aliu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykim mundë të ushtrohet ankesë në afatë prej 15 ditësh, nga dita e pranimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.